



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 136 Mars 2015 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>





Permbajtja:

Malisheva e përgatitur për shënimin e datave me rëndësi të Marsit	3
Kryetari Begaj priti konsullin turk për çështje fetar.....	4
Drejtori Morina takoi drejtorin zjarrfikësve në Halmstad të Suedisë	5
Një delegacion prej 6 anëtarësh nga SHFMU “Ibrahim Mazreku” shkojnë në vizitë në Suedi.....	6
Pronarët e furrave të gëlqeres, kërkojnë t’ju lejohet puna, me përdorim të druve për djegie	7
Kryetari Begaj dhe ministri Agani, shqyrtojnë mundësitë e përkrahjes në fushën e ambientit.....	8
Malisheva po shënon manifestimin “Epopenë e UÇK-së”	9
U shënuar Dita e Mësuesit	12
U shënuar 8 Marsi-Dita e Gruas	13
Bora e madhe po pengon qarkullimin në fshatrat malore	14
16 vite pas zhdukjes, rivarrosjet Dinë Halilaj	14
Bora deri në dy metra, por të gjitha rrugët e hapura	15
Komiteti për arsim mbajti mbledhjen e dhjetë të radhës	16
Përfundoi shpërndarja lopëve për fermerët në Malishevë	17
Kryetari Begaj, takoi kryetarin e Halmstadit në Suedi	18
Drejtorët e rinj, i marrin detyrat.....	19
Komiteti për Politik dhe Financa mbajti mbledhjen e radhës	20
Malisheva i ofron bashkëpunim institutit për hulumtimin e krimeve të luftës.....	20
Begaj, do të përkrahë nxënësit në pastrimin e ambientit	21
Qytetari sloven, dërgon ndihmë për persona në nevojë	22
Të hënën fillojnë ligjëratat për vetëdijesim nga rreziku i EHKK	23
Kanë filluar ligjëratat në shkolla për vetëdijesim nga rreziku EHKK	23
Filloi fushata e repelimit të kafshëve shtëpiake	24
Kryetari Begaj, takoi banorët e Maxharrës dhe Astrazupit	25
Begaj: Do ta rregullojmë rrugën Marali-Gajrak	26
Qytetarët kërkojnë rikthimin me regjionin e Prizrenit	27
Kryetari Begaj, takoi përfaqësuesit e LMT-së në Malishevë.....	28
Vazhdon projekti për përkujdesjen shëndetësore në mes Komunës dhe Caritas Kosova	28
Komuna do ta mbështes Shoqatën e të Verbërve në Malishevë	29
Kryetari Begaj, vazhdon të mbaj derën hapur për qytetarë	30



Begaj dhe Mustafa: Regjionalizimi sipas vullnetit të qytetarëve	30
KK i Malishevës nuk pranoi ndryshimin e statutit.....	31
Përkujtohet “Masakra e Burimit”	32

Malisheva e përgatitur për shënimin e datave me rëndësi të Marsit

Malishevë, 2 mars

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot takimin e rregullt, ku në mesin e shumë çështjeve, është biseduar edhe për shënimin e datave me rëndësi të marsit, ku përfshihet “Epopëja e UÇK-së” e 5,6 dhe 7 mars, pastaj 7 Marsi, Dita e Mësuesit dhe 8 Marsi, Dita ndërkombëtare e Gruas. Për shënimin e këtyre tri ngjarjeve, janë para disa aktivitete.

Sipas drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerita Krasniqi, për nderë të shënimit të “Epopës së UÇK-së”, bazuar edhe në agjendën shtetërore, janë planifikuar të mbahen aktivitetet zyrtare, duke filluar me një Akademi Përkujtimore, e për të vazhduar me homazhe në varrezat e dëshmorëve në komunën tonë dhe në Prekaz, si dhe aktivitete tjera që lidhen me shënimin e “Epopës së UÇK-së”.

Ndërsa drejtori për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaçi, tha se me në kuadër të shënimit të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, përveç aktiviteteve tjera tradicionale, siç janë garat në recitim, të cilat kanë përfunduar, me datën 6 mars, do të mbahet një aktivitet me mësuesit, veteranët e arsimit dhe të tjerë, dhe ky aktivitet mbahet në Shtëpinë e Kulturës, “Tahir Sinani”, duke filluar në ora 13:00.

Po ashtu, në Shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani”, me datën 9 mars, planifikohet të zhvillohet një aktivitet në kuadër të shënimit të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Ky aktivitet do të organizohet nga Komuna e Malishevës në bashkëpunim me OSBE-në, misioni në Kosovë.

Në mbledhjen e sotme, u diskutuan edhe çështje tjera me rëndësi, siç janë përgatitjet për evidentimin e saktë të numrit të të vrarëve në Komunën e Malishevës, dhe ngritja e një pllake përkujtimore me emrat e të vrarëve gjatë luftës së fundit.

Po ashtu u diskutua edhe për përgatitjet për fillimin e muajit të pastrimit, ku planifikohet të largohen disa deponi ilegale të mbeturinave, pastaj, projektin e rindërtimit të kadastrit, që po vazhdon në dy fshatra (Bellanicë dhe Damanek), për subvencionet në bujqësi, si dhe për

përgatitjet për fillimin e sezonit për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). E kur jemi tek EHKK, sipas drejtorit për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, për këtë vit, në fund të shkurtit, është regjistruar edhe rasti i parë e thumbimit nga rriqrat për vitin 2015.

Nga sektori i sportit, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, kërkoi që të fillohen procedurat dhe aktivitetet tjera për formimin e një ekipi të futbollit të madh, pasi tashmë si komunë, është planifikuar rregullimi i stadiumit dhe përmes kësaj, sportistëve të komunës sonë, t'u krijohen kushte për formimin e këtij klubi, cili fillimisht do të mbështetet edhe nga Komuna. Ekipi i futbollit, për kategorinë sendor, i mungon Malishevës, përderisa jemi një komunë, që në vazhdimësi, jep talent të futbollit.

Kryetari Begaj priti konsullin turk për çështje fetar

Malishevë, 2 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim, konsullin turk për çështje fetare, pranë Ambasadës së Republikës së Turqisë në Kosovë, z. Abudall Vasfi Yüce, me të cilin kanë biseduar për çështje të ndryshme, të bashkëpunimit mes Malishevës dhe Turqisë. Në këtë takim, morën pjesë edhe udhëheqja e Bashkësisë Islame në Malishevë.

Kryetari Begaj, e njoftoi konsullin turk, me Malishevën, me situatën e përgjithshme në Malishevë, me marrëdhëniet e përgjithshme në komunën tonë, me komunat në Republikën e Turqisë, si është binjakëzimi me Komunën e Orhangaz-it. Kryetari Begaj foli edhe për marrëdhëniet fetare në Malishevë, pasi shumica dërmuese, i takon religjionit islam, ashtu sikur edhe shumica e popullatës turke.

Nga ana tjetër, konsulli turk, pasi e falënderoi kryetarin Begaj për pritjen e ngrohtë, foli për marrëdhëniet e hershme të krijuara mes Turqisë dhe Kosovës, si dhe të vendeve ballkanike në përgjithësi. “Kosova është shumë e veçantë për Turqinë”, tha konsulli turk për çështje fetare, Abudall Vasfi Yüce.

Konsulli turk, foli për investimet në xhamia, përkatësisht ndërtimin dhe meremetimin e xhamive në Kosovë, ndërsa premtoi përkrahje për Malishevën, dhe krijimin kontakteve më të shumta me komunat turke, dhe kontaktet më të shpeshta me Komunën e Orhangazit.

Drejtori Morina takoi drejtorin zjarrfikësve në Halmstad të Suedisë

Malishevë-Suedi, 4 mars



Gjatë qëndrimit të tij zyrtar në Suedi, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, në mesin e takimeve të shumta, dje në qytetin e Halmstadit, është takuar me drejtorin e shërbimit të zjarrfikësve në këtë qytet, z.Hans Ekberg, me të cilin kanë biseduar për mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë mes këtyre dy drejtorive dhe shkëmbimit të eksperiencave në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit.

Drejtori Morina, ka vizituar edhe qendrën shërbimit të zjarrfikësve në Halmstad, ku është njoftuar me mënyrën e organizimit të këtij shërbimi. Po ashtu, drejtori Morina e ka ftuar drejtorin Ekberg, për një vizitë në Malishevë, në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit mes dy qyteteve.

Në kuadër të vizitës së tij në Halmstad, drejtori Morina, me ftesë të klubit të mërgimtarëve tanë në Suedi, gjatë ditës së sotme, do të vizitoj shkollën shqipe, me rastin e mbajtjes së kuizit të diturisë, e ku do të marrin pjesë edhe nxënës shqiptar nga Komuna e Malishevës, të cilët jetojnë në Suedi.

Po ashtu me ftesë të klubit të mërgimtarëve, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, do të ketë edhe disa aktivitete tjera në këtë zonë të Suedisë, ku përveç mërgimtarëve, do të ketë takime edhe me zyrtar tjerë lokal në Halmstad.

Një delegacion prej 6 anëtarësh nga SHFMU “Ibrahim Mazreku” shkojnë në vizitë në Suedi

Malishevë, 4 mars



Kryetari i Komunës z.Ragip Begaj , sot ka pritur drejtorin e shkollës fillore te mesme të ultë” Ibrahim Mazreku” në Malishevë z.Januz Mazreku dhe arsimtarin z.Hamdi Mazreku së bashku me nxënësit Alma Mazreku dhe Jon Krasniqi të cilët do të udhëtojnë për në Suedi , me një program “Mësimi pas shkolle” i cili është i koordinuar me Ministrin e Arsimit të Kosovës dhe atë të Diasporës. Kryetari ju dëshiroi udhëtim të mbarë dhe përmes këtyre nxënësve, i

përcolli përshëndetjet e tij për nxënësit shqiptar në Suedi.

Qëllimi i kësaj vizite është që nxënësit nga Atdheu të njihen me punën, veprimtarin, jetën dhe përditshmërinë e moshatarëve të tyre larg Atdheut, të njihen më për se afërmi me shkollat e tyre, mësimin e gjuhëve të tjera dhe gjuhës së tyre amtare. Të krijojnë shoqëri e miqësi të reja.

Ndërsa arsimtarët të njihen me jetën e bashkatdhetarëve të tyre, punën dhe funksionimin e mësimin të gjuhës shqipe në shkollat suedeze, mënyrën, metodat mësimore të shkollës shqipe jashtë Atdheut. Të thellohet bashkëpunimi me institucionet shkollore kosovare dhe ato suedeze.

Në këtë Program “Mësimi pas shkolle” do të marrin pjesë nxënësit dhe arsimtarët e komunës së Malishevës, Prishtinës dhe Mitrovicës.

Pronarët e furrave të gëlqeres, kërkojnë t’ju lejohet puna, me përdorim të druve për djegie

Malishevë, 4 mars



Sot në Malishevë, është mbajtur një takim mes Drejtorisë së Inspektoratit, Inspektorëve të Ministrisë së Ambientit dhe pronarëve të furrave për përfitimin e gëlqeres, ku këta të fundit janë njoftuar me zbatimin e ligjit, që ka të bëjë me mbrojtjen e ajrit, përkatësisht me ndalimin e përdorimit të gomave dhe plastikës, për djegien e furrave, e nga ana tjetër, pronarët e furrave kërkuan që t’ju lejohet vazhdimi i veprimtarisë, me përdorim të drurit për djegie.

Drejtori i Inspektoratit, z.Sejdi Paçarizi, fillimisht, i falënderoi pronarët e këtyre furrave, të cilët, kishin shprehur gatishmërinë e tyre, për zhvilluar këtë takim, në mënyrë që të njihen me ligjin, i cili ndalon përdorimin e gomave për djegie.

Ndërsa më gjerësisht për këtë problematikë, foli z.Mustafë Hyseni, nga Inspektorati i Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, ku sipas tij, përveç se është kusht në raportin e progresit, përdorimi i gomave për djegie, është rreptësisht i ndaluar, për shkak të ndotjes së ambientit dhe ndikimit jashtëzakonisht në madh, negativ në shëndetin e qytetarëve dhe në eko sistem.

“Viti 2015, është viti i ndalimit përfundimtar të përdorimit të gomave për djegie dhe çdo furrë e cila do të bëjë këtë, do të rrënohet. Ky është vendim përfundimtar dhe ne do ta zbatojmë këtë”, tha inspektori Hyseni, duke i paralajmëruar me masat ndëshkuese.

Nga ana tjetër, pronarët e furrave për përfitimin gëlqeres nga Bardhi dhe Guncati, kërkuan që mos t’ju mbyllen furrat, pasi këtë e kanë burim të jetesës, por u zotuan se do të përdorin drurin për djegien e furrave. Ndërsa njëri nga pronarët, z.Selman Krasniqi, tha se “përfitimi i gëlqeres është edhe burim i jetesës, por edhe një traditë e trashëguar brez pas brezi dhe këtë traditë duan ta vazhdojnë, pasi është një trashëgimi, e cila i ka mbajtur gjallë banorët e kësaj ane”.

Imer Berisha, në emër të pronarëve të furrave nga fshati Bardh, duke folur në emër të të gjithë pronarëve, tha se “zotohemi për përdorimin e druve për djegie dhe çdo person që eventualisht, nga sot e tutje do të përdor goma apo plastikë, do të lajmërohet tek organet gjegjëse nga vet banorët dhe ky është një vendim unanim i marrë nga të gjithë”.

Drejtori i Inspektoratit, z.Sejdi Paçarizi, i paralajmëroi, se inspektorati dhe Policia e Kosovës, do ti vëzhgojnë vazhdimisht, 24 orë në ditë dhe nëse dikush përdor vetëm një gomë, do të merren

masat ndëshkuese. Sipas inspektorëve të ministrisë, furrat do të rrënohen dhe shpenzimet do ti bartin vet pronarët e furrave.

Përndryshe, furrat për përfitimin e gëlqeres, janë burimi kryesor i jetesës për shumicën e banorëve të pjesës që jetojnë përgjatë maleve të Berishës dhe kjo është një traditë e trashëguar që nga kohët e lashta. Ndërsa viteve të fundit, me përdorimin e gomave, është shkaktuar ndotje e madhe e ambientit dhe shumë banorë ankohen edhe për rrezikun nga sëmundjet kancerogjene. Por shumë pronarë të furrave, thanë se edhe përdorimi i druve, mund të ketë pasoja n degradimin e pyjeve, prandaj, kërkojnë një zgjidhje për punësim, në mënyrë që të ruhet ambienti.

Kryetari Begaj dhe ministri Agani, shqyrtojnë mundësitë e përkrahjes në fushën e ambientit

Prishtinë, 4 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot është pritur nga ministri i Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, z.Ferid Agani, me të cilin kanë biseduar për çështje të ndryshme që lidhen me fushën e ambientit dhe planifikimit hapësinor, si dhe për çështjen e etheve hemorragjike.

Ministri Agani u njoftua për së afërmi nga kryetari Begaj, me problemet me të cilat po ballafaqohet Komuna e Malishevës, dhe njëkohësisht u shqyrtua mundësia e përkrahjes së projekteve konkrete në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor.

Kryetari Begaj, shpalosi disa projekte që kanë të bëjnë me trajtimin e ujërave të zeza, çështjen e rregullimit të shtratit të Lumit Mirusha, por edhe mundësinë e organizimit të një kampanje për pastrimin e mjedisit në këtë komunë.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua edhe çështjes së rriqrave, problem ky që Komuna e Malishevës përballet çdo vit. Begaj bëri të ditur se kanë ndarë rreth 250 mijë euro që do të përdoren për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

Ministri Agani, tha se “si pjesëtar i Këshillit ndërmintor për luftimin e etheve hemorragjike, do të angazhohet në maksimum që t’i përgjigjet kërkesave të Komunës dhe komunitetit të atjeshëm, ngase vitet e kaluara nga pickimi i rriqrave kanë humbur jetën disa qytetarë”.

Malisheva po shënon manifestimin “Epopenë e UÇK-së”

Malishevë, 6 mars



Në kuadër të shënimit të manifestimit të “Epopëja e UÇK-së”, Komuna e Malishevës përmes aktiviteteve të ndryshme, ka nderuar veprën e dëshmorëve të kombit, të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe sakrificën e familjes Jashari. KK i Malishevës, me këtë rast ka mbajtur një mbledhje solemne dhe ka bërë homazhe në Prekaz dhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë.

Në mbledhjen solemne, të mbajtur nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, në fjalën e tij, Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, tha “ne sot po shënojmë njërën nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, po shënojmë “Epopenë e Lavdishme të UÇK-së”, po kujtojmë rënien heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së gjerë Jashari në marsin e vitit 1998”.

Kryetari Begaj, duke folur për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tha se “nuk ka vepër më madhështore se ajo e çlirimit të vendit”. Më pas Begaj foli edhe për kontributin e Malishevës, në luftën çlirimtare.

Ndërsa kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, duke marrë fjalën, fjalimin e tij e nisi me citatin, “Nëse duhet të vdes dikush, më mirë të vdesim ne, se sa Atdheu” e kjo ishte thënia-vendimi i shenjtë i Komandantit Legjendar Adem Jashari, e bërë realitet se për të jetuar Atdheu, ne duhet të luftojmë”.

Sipas kryesuesit Thaçi, “rënia e familjes Jashari, u bënë shembulli më kuptimplotë i sakrificës dhe flijimit për lirinë e vendit”.

Pas mbledhjes solemne, një delegacion i gjerë nga Komuna e Malishevës, ku përfshiheshin, anëtarët e KK të Malishevës, familje të dëshmorëve, veteran të luftës, përfaqësues të klerit, me në krye Kryetarin e Komunës, z.Ragip Begaj, fillimisht bënë nderime para shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në sheshin e dëshmorëve në Malishevë, pastaj në varrezat



e dëshmorëve në Malishevë, në kompleksin memorial në Prekaz dhe në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë.

Në vazhdim, fjalimi i kryetari Begaj, mbajtur në seancën solemne të KK të Malishevës:

Të nderuara familje të dëshmorëve

Invalidë dhe veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Të nderuar anëtarë të Asamblesë Komunale të Malishevës

Ish-kryetarë të Komunës së Malishevës, pjesëtarë të Policisë së Kosovës, përfaqësues të Bashkësisë Islame dhe ju të nderuar pjesëmarrës

Sot, ne po shënojmë një rën nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, po shënojmë “Epopenë e Lavdishme të UÇK-së”, po kujtojmë rënien heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së gjerë Jashari në marsin e vitit 1998.

Okupimi serb në Kosovë, kishte arritur kulmin dhe populli shqiptar, filloi që të ndryshoj rezistencën e tij, pasi organizimi ushtarak kishte mbetur mënyra e vetme që ne ta fitojmë lirinë. Si rezultat i të gjitha ngjarjeve të deri- atëherëshme, u formua Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me në krye Komandantin Adem Jashari.

Nuk ka vepër më madhështore se sa ajo e çlirimit të vendit. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte kryevepër e përpunimit të idesë së lirisë, mjet dhe projekt strategjik i realizimit të kësaj ideje ishte populli i Kosovës

Duke parë këtë, shteti serb ndërmori disa herë fushata ushtarake dhe policore, në tentim për ta shuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, përkatësisht eliminimin e komandantit të saj, Adem Jasharit. Kështu, më 30 dhjetor 1991, organizuan aksionin e parë kundër familjes Jashari në Prekaz, por ky tentim dështoi, pasi nuk arritën t’i thyejnë Jasharajt. Më pas, më 26 nëntor 1997, në Llaushë të Re, ishte tentimi i dytë për kapjen e Adem Jasharit, për të vazhduar me tentimin e tretë më 22 janar 1998, që të gjitha këto tentime nuk patën sukses.

Shteti policor dhe ushtarak, ende besonte se me kapjen, vrasjen apo eliminimin e Adem Jasharit, do t’i shuante përpjekjet për liri. Kështu, më 5 mars filloi aksioni i madh për kapjen e Adem Jasharit, por hasi në rezistencë të fortë të Jasharajve të Prekazit, të cilët bënë rezistencë të paparë në historinë e njerëzimit, pasi luftuan për tri ditë të tëra, derisa u vranë shumica prej tyre. Pra, kjo ofensivë u bë më 5,6 dhe 7 mars 1998.



Me flijimin e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, botës iu bë e qartë se populli shqiptar është i gatshëm të vdesë për lirinë e vendit të vet. Kjo është epopeja e madhe, të cilën e bëri Adem Jashari me familje. Ai flijim ndezi zemrat e shqiptarëve dhe detyroi botën ta shihte të vërtetën.

Ditët e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës treguan më së miri se me çfarë sakrifice u përballën shqiptarët në betejën për ta fituar lirinë. Burrat legjendarë të familjes Jashari, gratë dhe fëmijët e një lagje të tërë u flijuan duke treguar heroizëm të rrallë.

Në këtë kontekst komandanti Adem Jashari është dhe do të mbetet tërësisht i gjallë, ideali i tij nuk do të vdesë kurrë, atdheadashuria e tij deri në sakrificën sublime që do të kultivohet brez pas brezi, guximi i tij i trashëguar nga lavdia nëpër shekuj e kombit tonë do të përcillet edhe në shekujt e ardhshëm, si një porosi e shenjtë dhe detyrim atdhetar për çdo brez shqiptarësh.

Epopeja e UÇK-së dhe rënia heroike e legjendarit Adem Jashari dhe familjes Jashari, i shembi dy iluzione të mëdha: e para se liria e Kosovës mund të arrihej vetëm me rezistencë paqësore dhe me mjete e aksione politike, pa luftë dhe pa sakrifica të mëdha, e po ashtu shembi edhe iluzionin e bashkësisë ndërkombëtare se çështja e Kosovës ende mund të trajtohej dhe zgjidhej brenda kornizës së asaj karikature që kishte mbetur nga shpërbërja e Jugosllavisë.

Epopeja e shembi përfundimisht iluzionin se Kosova dhe Serbia do të mund të jetonin nën një kulm.

Lufta dhe rënia heroike në Prekaz, u bë kushtrim për shtrirjen e Ushtrisë Çlirimtare në tërë Kosovën pasi tashmë shihej qartë se ishte moment final i realizimit të aspiratave të shqiptarëve, realizim i sakrificave të panumërta në krejt historinë tonë të dhembshme.

Kushtrimi i rënies së komandantit Adem Jashari dhe familjes së tij me shpejtësi të rrufeshme u përhap edhe në Malishevë.

Qytetar të nderuar të Malishevës, unë dhe ju të gjithë jemi krenar për kontributin e malishevasve, të të gjithë brezave, që dhanë për lirinë e vendit.

Mijëra djem e vajza u rreshtuan menjëherë në radhët e Njësiteve “Lumi” dhe “Çeliku” të UÇK-së për të dhënë kontributin e tyre në lirinë e Kosovës, kurse secila shtëpi u bë çerdhe për ushtarët e lirisë.

Në histori do të mbeten qindra beteja të zhvilluara në Malishevë, në Dragobil, Lladroc, Bellanicë, Carrallukë, Drenoc, Kijevë, Bubavec, Mirushë, Balincë, Bllacë dhe në të gjitha



vendbanimet tjera, të cilat u bënë shembuj të luftës dhe qëndresës për liri. Në këto beteja, Malisheva i dha kësaj toke mbi 70 dëshmorë të kombit

LAVDI Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

U shënuar Dita e Mësuesit

Malishevë, 6 mars



Komuna e Malishevës, përkatësisht drejtoria komunale për arsim dhe shkollat e Komunës së Malishevës, përmes aktiviteteve të ndryshme kanë shënuar Ditën e Mësuesit. Ndërsa në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani”, organizuar nga DKA është mbajtur takimi qendror, ku janë nderuar mësuesit për punën e tyre, si dhe janë nderuar edhe veteranët e arsimit të trevës sonë.

“Jemi në kuadër të shënimit të datave më të shenjta të popullit shqiptar, të 5,6 dhe 7 marsit të Epopesë së lavdishme të UÇK-së dhe të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, dy nga datat me më rëndësi në historinë e popullit shqiptar”, tha kryetar Begaj, duke marrë fjalën, me rastin e shënimit për nderë të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit.

Më pas, kryetar Begaj, e vlerësoi lartë punën dhe angazhimin e mësuesve shqiptar ndër vite dhe përpjekjet e tyre, në arsimimin e popullit shqiptar. Po ashtu Begaj, foli edhe për kontributin e jashtëzakonshëm të mësuesve tanë në luftën e UÇK-së, kujtoi sakrificat e mësuesve dhe punëtorëve të arsimit, sakrificë, e cila siç tha kryetari Begaj, “na obligon neve të punojmë edhe më shumë, e sidomos në krijimin e kushteve më të mira për mësimdhënësit”.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaçi, pasi i përshëndeti të gjithë mësimdhënësit e Komunës së Malishevës, tha se “në këtë kremtim të përbashkët, ne të gjithë mund të pasqyrojmë energjitë tona, për të rikujtuar shtegtimin tonë historik e kombëtar, për dinjitet e prosperitet kombëtar”. “Sot ne përkujtojmë figurat më të ndritura të kombit tonë, kujtojmë Marsin, muajin e bekuar që na solli edhe shkollën e parë shqipe”, tha drejtori Thaçi.

Më pas, DKA e Malishevës, ka ndarë mirënjohje për shkollat e dalluara në mësim dhe në mirëmbajtje të ambientit, pastaj për mësuesit më të dalluar, për kontributin e tyre. Punëtorët e arsimit, pas vdekjes. Pastaj janë ndarë mirënjohje edhe për nxënësit e dalluar, recitues dhe

matematikan, të cilët kanë dalë fitues në garat e mbajtura, në kuadër të shënimit të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit.

U shënua 8 Marsi-Dita e Gruas

Malishevë, 7 mars



Organizuar nga Komuna e Malishevës, zyra për Barazi gjinore dhe OSBE misioni në Kosovë, është shënuar Dita Ndërkombëtare e Gruas, përmes aktiviteteve të ndryshme. Me këtë rast është vlerësuar lartë roli i gruas. Në këto aktivitete dhe me rastin e 8 Marsit, edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka uruar gratë malishevase, si dhe i ka inkurajuar ato që të jenë edhe më aktive dhe të luajnë rol të rëndësishëm në vendimmarrje.

Në një nga aktivitetet e organizuara sot, është shfaqur dokumentari “Ato ia dolën”, dokumentar i cili u mundësua nga ekipi i OSBE-së në Malishevë dhe zyra për barazi gjinore. Në këtë aktivitet, mori edhe Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, deputetja e Kuvendit të Kosovës znj.Shukrie Bytyçi kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Aziz Thaçi dhe drejtoresha e DRKS-së znj.Blerta Krasniqi.

“Komuna e Malishevës nga aspekti i barazisë gjinore qëndron mirë, këtu motrat tona punojnë dhe kontribuojnë shumë për barazi, ju inkurajoj të gjitha që të angazhoheni më shumë që të gjitha femrat të punojnë dhe mos të presin nga bashkëshortët e tyre. Të jeni dhe ju deputete, drejtoresha, profesoresha, etj...” tha mes tjerash Kryetari Begaj në fjalën e rastit. “Shkollimi i femrës është i domosdoshëm” ishte mesazhi që i kryetarit Begaj.

Një fjalë rasti, në këtë aktivitet e ka mbajtur edhe përfaqësuesi i OSBE-së, Yusuke Hara, cili përveç urimit, i ka inkurajuar gratë, për aktivitetet e tyre, duke ju ofruar edhe mbështetjen e OSBE-së.

Nga ana tjetër deputetja e Kuvendit të Kosovës znj.Shukrie Bytyçi, përshëndeti dhe uroi të gjitha femrat e të gjitha komunave dhe në veçanti mësueset, për kontributin në edukimin e brezave të tërë dhe brezave të rinj që po e bëjnë. Më pastaj znj.Arlinda Thaçi, anëtare e KK të



Malishevës, ka bërë prezantimin e Grupit jo formal të Grave të Komunës së Malishevës, që është formuar në nëntor të vitit 2014.

Më pastaj kryetari Begaj ka ndarë edhe një mirënjohje për znj.Mihrije Bytyçi, e cila është nga gratë e suksesshme të komunës sonë. si një grua e suksesshme, për kontributin e dhënë, në emancipimin e femrave në rajonin tonë.

Bora e madhe po pengon qarkullimin në fshatrat malore

Malishevë, 9 mars

Në mbledhjen e sotme të rregullt të Këshillit të Drejtorëve, që drejtohet nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në mesin e shumë çështjeve, dy kanë qenë temat më me rëndësi që janë trajtuar. Rrugët e bllokuara nga bora në fshatrat që shtrihen në malet e Berishës dhe çështja e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

Në këtë mbledhje, kryetari Begaj, cili gjatë gjithë vikendit ka qëndruar në terren, bashkë me përgjegjësit tjerë komunal, njoftoi se rrugët në fshatrat Berishë, Fshat i Ri dhe rruga drejt fshatit Kleçkë (Komuna e Lipjanit), vazhdojnë të jenë të kalueshme me shumë vështirësi dhe në këtë pjesë duhet kujdes i vazhdueshëm për largimin e borës.

“Kompania e cila merret me pastrimin e rrugëve nga bora, po qëndron në këto fshatra, pasi erërat po e bartin borën dhe në vazhdimësi po i mbulojnë rrugët, duke shkaktuar kështu probleme serioze në qarkullimin e banorëve të këtyre fshatrave”, njoftoi kryetari Begaj, përderisa rrugët në vendbanimet tjera, janë të qarkullueshme dhe nuk ka probleme të mëdha.

Në çështje tjetër të cilën kryetari Begaj, e ka diskutuar në mbledhjen e sotme, është edhe ajo e implementimit të strategjisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo. Me këtë rast drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, tha se “ deri më tani janë paraqitur dy raste të thumbimit nga rriqrat dhe pavarësisht prej kushteve atmosferike, shumë shpejt besoj se do të filloj repelimi i kafshëve shtëpiake, si njëra prej masave parandaluese, si dhe po punohet intensivisht në vazhdimin e vetëdijesimit për rrezikun nga thumbimi i rriqrave”.

16 vite pas zhdukjes, rivarroset Dinë Halilaj

Malishevë, 9 mars



16 vite pas zhdukjes, sot janë rivarrosur eshtrat e identifikuara të Dinë Halilajt (1948) nga fshati Llapqevë. Në ceremoninë e varrimit, u tha se edhe sot, pas 16 viteve, vazhdojmë të kemi plagë të hapura, pasi armiku u mundua ti zhdukë gjurmët e krimit, ndërsa ju bë me dije edhe bashkësisë ndërkombëtare, se ne kurrë nuk do ti harrojmë të vranët.

“Është përjetim i rëndë, që ka zgjatur 16 vite për familjen Halilaj, në pritje të një lajmi për prindin e tyre, e Komuna e Malishevës, lirinë që e kemi, e ka larë me gjak dhe çdo vendbanim i yni ka derdhur shumë gjak për këtë liri”, tha mes tjerash në fjalën e rastit, Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj. “Qeveria e vendit, është dashur të kushtëzoj negociatat me çështjen e të pagjeturve. Ne të gjallët kemi obligim ndaj të vranëve dhe këtë ja bëjmë me dije edhe bashkësisë ndërkombëtare, se ne nuk i harrojmë të vranët tanë”, tha Begaj.

Ndërsa, kryetari komisionit qeveritar për të pagjeturit, z.Prenk Gjetaj, tha se “edhe pas 16 viteve ne vazhdojmë të kemi plagë të hapura, pasi ende mungojnë shumë persona të zhdukur. Armiku tentoi që ta fsheh krimin, për ti ikur përgjegjësisë, duke i fshehur të vranët, por kësaj përgjegjësie kurrë nuk do të mund ti ik. Dina dhe të tjerët, u vranë duke mbrojtur pragun e tyre”.

Për biografinë e Dinë Halilajt, foli, drejtori i shkollës së fshatit, z.Aziz Avdiu, pasi Dinë Halilaj, ishte punëtor i kësaj shkolle. “Në marsin e vitit 1999, banorët e Llapqevës, u detyruan të largohen nga fshati, dhe familja e Dinë Halilajt, shkoi në Kralan, ku me 2 prill, Dina u nda me forcë nga familja. Pas dy ditësh, edhe pse u lirua, Dina nuk pranoi ta lë djalin tij Naimin në duart e forcave paramilitare serbe, duke kërkuar që të qëndroj ai, ndërsa djali të lirohej. Por e morën Dinën dhe bashkë me djalin, u vranë në masakrën e Kralanit, sikur edhe shumë bashkëfshatar tjerë të Llapqevës, të cilët vazhdojnë të konsiderohen të zhdukur edhe sot”.

Në emër të familjes, pjesëmarrësit e shumë në ceremoninë e varrimit, i ka falënderuar Sylë Halilaj.

Bora deri në dy metra, por të gjitha rrugët e hapura



Malishevë, 10 mars

Bora në malet e Berishës, ku gjinden disa fshatra të Komunës së Malishevës, ka arritur në disa



vende deri në afro dy metra, mirëpo rrugët nga pasditja e djeshme, janë të gjitha të kalueshme dhe nuk ka asnjë rrugë të bllokuar nga bora. Këto fshatra sot i ka vizituar përsëri kryetari i Komunës së Malishevës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ku ka parë nga afër rrugët e këtyre fshatrave, si dhe punën që ka bërë njësia e “Eko regjionit” në Malishevë, e cila i ka hapur të gjitha rrugët.

Banorët e Berishës dhe Fshatit të Ri, dy fshatrat më të thella, kanë falënderuar komunën dhe të gjithë punëtorët e “Eko regjionit”, të cilët për 48 orë pa ndërprerë kanë punuar në hapjen e rrugëve, pasi sasia e borës ishte shumë e madhe dhe erërat kanë bartur borën, duke krijuar pengesa të mëdha në rrugë.

Kompania “Eko regjioni”, përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dimrit, gjatë tërë fundjavës ka qenë e angazhuar në largimin e borës nga rrugët, ndërsa në 48 ortë e fundit, kanë qenët të angazhuar vetëm në këtë pjesë, ku me katër makina të rënda, kanë larguar borën nga rrugët, duke e mundur qarkullimin e banorëve të kësaj pjesë dhe lidhjen me qendrën komunale.

Kryetari i fshatit Berishë, z.Eshref Berisha, pasi u takua me kryetarin Begaj, e ka falënderuar atë për angazhimin e komunës në hapjen e rrugëve në këtë pjesë, si dhe për vizitat e vazhdueshme dhe kujdesin e treguar. Berisha, po ashtu ka falënderuar të gjithë ata që anë qenë të angazhuar në largimin e borës.

Komiteti për arsim mbajti mbledhjen e dhjetë të radhës

Malishevë, 11 mars

Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, ka mbajtur sot mbledhjen e dhjetë të radhës, të cilën mbledhje e kryeson z. Januz Kastrati. Komiteti në mbledhjen e sotme, kanë diskutuar se si ka vijuar organizimi i Festave të Marsit.

Para anëtarëve të këtij komiteti rreth organizimit të Festave të Marsit, ka raportuar drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport (DKRS), znj.Blertha Krasniqi me rastin e Epopesë së UÇK-së rreth aktiviteteve të përgjithshme, të datave 5,6 dhe 7 marsit, se si kanë vijuar.

Nga ana tjetër ka raportuar edhe drejtori i DKA-së z.Blerim Thaçi për garat e përgjithshme të nxënësve, ato në lëndën e matematikës dhe të recitatorëve, për suksesin e treguar në këto gara nga ana e nxënësve, ndarjen e mirënjohjeve për mësime dhe nxënësit e dalluar për nder të festës së 7 Marsit- Ditës së Mësuesit.

Përfundoi shpërndarja lopëve për fermerët në Malishevë

Malishevë, 13 mars



Në kuadër të investimeve të Komunës së Malishevës, në fushën e bujqësisë, përkatësisht blegtorisë, me qëllim të përkrahjes të fermerëve vendas, sot ka përfunduar projekti i shpërndarjes së lopëve qumështore për fermerët e komunës së Malishevës. Në përfundim të këtij projekti ishte i pranishëm nënkryetari z.Rexhep Mazreku së bashku me drejtorin për bujqësi z.Hajrullah Mazreku.

Sipas drejtorit për Bujqësi z.Hajrullah Mazreku, ky projekt është realizuar me sukses ku përfitues kanë qenë 49 fermer, ky projekt është realizuar me bashkëfinancim me fermerët. Shuma e projektit ka qenë 74480,00 euro, ku komuna ka participuar me 70 përqind, kurse fermerët me 30 përqind.

Në mes tjerash drejtori Mazreku tha “ ky nuk do të jetë projekt i vetëm, përkrahja do të jetë e vazhdueshme për të gjithë fermerët vendas, jo vetëm në blegtori, por në të gjitha sektorët e bujqësisë dhe do të ketë edhe shumë projekte të tjera në vazhdimësi ”.

Kryetari Begaj, takoi kryetarin e Halmstadit në Suedi

Malishevë – Halmstad (Suedi), 15 mars



Një delegacion i Komunës së Malishevës, i prirë nga kryetari Begaj dhe disa drejtor komunal, po qëndrojnë Halmstad të Suedisë. Në kuadër të vizitës, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, është takuar me kryetarin e Halmstadit, z. Carl Fredrik Graf, me të cilin kanë biseduar për çështje të ndryshme të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe për integrimin e kosovarëve në institucionet suedeze.

Begaj dhe Graf, kanë biseduar për bashkëpunim të ndërsjellë mes Malishevës dhe Hamstaldit, në të gjitha sferat e mundshme të bashkëpunimit.

Delegacioni nga Malisheva, po qëndron në Suedi, me ftesë të shoqatave shqiptare në Suedi, me rastin e shënimit të tridhjetë vjetorit të shkollës shqipe në Suedi, e ku mësues i parë ka qenë veprimtari nga Malisheva, z.Nuhi Mazreku, ku me këtë rast, kryetari Begaj, i ka dhënë edhe një mirënjohje, me emblemën e Komunës së Malishevës, për kontributin e tij në diasporë.

Po ashtu mbrëmë, delegacioni nga Malisheva, mori pjesë në tubimin, me program kulturo-artistik, me rastin e 30 vjetorit të shkollës së parë në gjuhën shqipe në Halmstad, ku mësuesi i parë ishte Nuhi A.Mazreku nga Malisheva, e që atë shkollë e filloi me dy nxënës, ndërsa sot në këtë shkollë ndjekin mësimin në gjuhën shqipe 270 nxënës. Kjo është meritë e bashkëvendësit tonë Nuhi Mazrekut.

Drejtorët e rinj, i marrin detyrat

Malishevë, 18 mars



Pas marrëveshjes politike për bashkëqeverisje, mes NISMA-s (IQM-së), si subjekti më i madh në Kuvendin e Komunës së Malishevës dhe LDK-së në Malishevë, sot tre drejtorët e përcaktuar nga ana e LDK-së, kanë marrë zyrtarisht detyrat e tyre. Me këtë rast edhe është bërë pranim dorëzimi i detyrave në Drejtoritë për Administratë të Përgjithshme, për Urbanizëm dhe atë për Gjeodezi dhe Kadastër.

Drejtorët e emëruar nga LDK në Malishevë, janë: Sami Kafexholli- drejtor i Administratës, i cili e mori detyrën nga Ekrem Kastrati, pastaj Skender Rrahmanaj në drejtorinë për Urbanizëm, i cili e mori detyrën nga Urim Kastrati dhe Fatmir Ademaj në drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, i cili e mori detyrën nga Fadil Shala.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka uruar drejtorët e rinj, për detyrat e tyre, si udhëheqës të drejtorive, ndërsa drejtorët e deritanishëm, i ka falënderuar për punën e bërë, për



më shumë se një vit, punë e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në suksesin e qeverisjes për më shumë se një vit, sa i kanë udhëhequr drejtoritë përkatëse.

Komiteti për Politik dhe Financa mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 18 mars

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtuar nga kryesuesi i KK-së, z.Aziz Thaçi, ka mbajtur mbledhjen e dytë të radhës në këtë vit, ku kanë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, më saktësisht i kanë dhënë 9 rekomandime, të cilat pritet të shqyrtohen në seancën e radhës së KK-së.

Rekomandimet nga anëtarët e KPF-së të cilat i adresohen KK-së janë: Shqyrtimi i propozimit për ndryshime në statutin e komunës, pastaj plani i punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2015, të hyrat vetanake të cilat duhet të barten nga viti 2014 në vitin 2015, e që kanë të bëjnë me tejkalimin e të hyrave vetanake, pastaj rekomandime tjera janë edhe tri rregullore, ajo për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2015, rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe rregullorja për bursave, po ashtu u bë rekomandimi i dy raporteve të punës për 2014 i Komitetit për Arsim dhe Komisionit Komunal të Aksionarëve, shqyrtimi dhe miratimi propozim planit të punës për 2015, si dhe plotësimi dhe ndryshimi i rregullores për mirëmbajtjen e varrezave.

Malisheva i ofron bashkëpunim institutit për hulumtimin e krimeve të luftës

Malishevë, 19 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, z.Abedin Selimaj, bashkëpunëtor profesional në Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë mes këtij instituti dhe Komunës, për hulumtimin e krimeve të luftës, me ç'rast, kryetari Begaj, ka ofruar bashkëpunimin e plotë të komunës, për hulumtimin e krimeve të bëra gjatë luftës së fundit.

Fillimisht, z.Selimaj, e ka informuar

kryetarin, me punën e institutit në hulumtimin e krimeve dhe nevojën e madhe për kryerjen e këtij hulumtimin, në mënyrë që të dihen saktësisht krimet e bëre, duke filluar nga vrasjet, dhunimet, dëmet në trashëgiminë kulturore, dëmet në ekonomi dhe të gjitha dëmet tjera.

Nga ana tjetër, kryetari Begaj, e quajti pak të vonuar hulumtimin e krimeve të luftës, mirëpo ofroi bashkëpunim dhe furnizim me materialet që disponon Komuna e Malishevës, të grumbulluara menjëherë pas luftës. “Të gjitha dëshmitë që ka komuna, do të jenë në shërbimin e institutit”, i ka thënë Begaj, përfaqësuesit të Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, z.Abedin Selimaj.

Begaj, do ti përkrahë nxënësit në pastrimin e ambientit

Malishevë, 19 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka pritur sot në një takim nxënësit e klasës së pestë të shkollës fillore “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, të cilët janë fitues të projektit “Kosovision kontest”, për klasat e pesta, dhe ideja e tyre është pastrimi i qytetit, për çka morën përkrahjen e kryetarit Begaj, për mbështetje të projektit, si dhe për pjesëmarrje në fushatën e pastrimit të ambientit në qytet. Ndihmë për realizimin e këtij projekti, ofroi edhe njësisia e “Eko regjionit” në Malishevë.

Sipas mësueses Violeta Marmullaku dhe nxënësve J.Krasniqi, R.Morina E.Mazreku, janë fitues të projektit dhe iniciativa është për pastrimin e ambientit në qytetin e Malishevës, kurse shumica e fituar për këtë projekt, është pesëqind euro, por kjo nuk është shumë e mjaftueshme për realizimin e projektit, për çka nxënësit kërkojnë edhe ndihmën e komunës dhe donatorëve tjerë nga sektori i biznesit në Malishevë.



Kryetari Begaj, duke shprehur kënaqësinë e tij për këtë iniciativë, tha, “ më vjen mirë që ju keni ide dhe vullnet për një aktivitet të tillë të pastrimit”. Më pas kryetari Begaj, tha se “mirëmbajtja e ambientit, është edhe njëra prej qëllimeve me shumë prioritet dhe të gjithë së bashku, mund ta pastrojmë dhe ta mirëmbajmë ambientin në përgjithësi dhe qytetin në veçanti”. Kryetari Begaj, premtoi që do ta përkrahë këtë iniciativë dhe do të jetë pjesë aktive.

Projekti pritet të realizohet më 22 prill në Ditën Ndërkombëtare të Tokës, kurse aksionin e nxënësve të klasës së pestë, sipas menaxherit të njësisë së kompanisë “Eko regjioni” në Malishevë, z.Nuhi Shala, do ta përkrahë me mjete konkretizuese.

Qytetari sloven, dërgon ndihmë për persona në nevojë

Malishevë, 20 mars



Ishëfan Hagy, qytetar sloven nga qyteti Litija në Slloveni, përmes bashkatdhetarëve tanë, ka bërë një gjest human, duke dërguar një shumë simbolike të mjeteve, për persona në nevojë. Ndërsa bashkatdhetarët, këto mjete i kanë sjellë në komunë dhe përmes drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, është zgjedhur një person, me gjendje të rëndë sociale dhe shëndetësore, së cilës i është dhënë kjo ndihmë.

Ndihma e qytetarit sloven, i është dhënë Hyrë Telakut (1980) nga Banja, familja e së cilës jeton në kushte të rënda ekonomike dhe sociale, ndërsa ajo, është e sëmurë rëndë dhe për këtë qëllim, kjo ndihmë i është dhënë kësaj familje. Shumën prej pesëdhjetë eurove, kësaj familjeje, ja dha kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Hajdin Berisha, të cilët edhe i premtuan vazhdimin e mbështetjes nga ana e komunës.

“Pavarësisht shumë, kjo është ndihmë e madhe nga një qytetar i huaj për njerëzit tanë, dhe unë e falënderoj z.Hagy, për gjestin e tij human”, tha me këtë rast, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Ndërsa, drejtori për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, z.Hajdin Berisha, pas vizitës në këtë familje, përveç kujdesit të vazhdueshëm që ju jepet nga ana e institucioneve shëndetësore komunale, drejtorja që ai udhëheq, tha se “do të vazhdoj t’ia siguroj barnat e nevojshme për terapinë e saj”. Edhe drejtori Berisha, e vlerësoi lartë gjestin human të qytetarit sloven.



Familja Telaku, e ka falënderuar sllovenin, për këtë ndihmë, e cila në realitet për familjen e tyre, është ndihmë shumë e madhe. Po ashtu, ata falënderuan edhe komunën, për kujdesin e vazhdueshëm.

Kjo familje jeton një shtëpi, të cilën po ashtu e kanë të ndërtuar nga njerëzit e vullnetit të mirë dhe janë shumë të varur nga ndihmat dhe nga kujdesi i komunës.

Të hënën fillojnë ligjëratat për vetëdijesim nga rreziku i EHKK

Malishevë, 22 mars

Nën organizimin e drejtorisë komunale për shëndetësi, nga dita e hënë 23 mars, do të fillojnë ligjëratat, nëpër shkollat e Komunës e Malishevës, për vetëdijesimin e nxënësve, me qëllim të mbrojtjes nga thumbimi i rriqrave si masë parandaluese kundër infektimit me ethet hemorragjike krime kongo (EHKK).

Sipas drejtorit për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, ligjëratat do të fillojnë nga dita e hënë (23 mars) në Bellanicë, Kijevë, Pagarushë, Carrallukë, Llozicë dhe Dragobil, për të vazhduar më pas sipas orarit të paraparë. Drejtori Berisha, tha se ‘janë të njoftuar të gjithë drejtorët e shkollave për orarin e mbajtjes së ligjëratave’.

“ligjëratat do të mbajnë personeli mjekësor i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Malishevë dhe këto ligjëratat janë në kuadër të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK)’, tha drejtori Berisha.

Në këto aktivitete, përveç ligjëratave profesionale nga personeli mjekësor, nxënësve do t’iu shpërndahen edhe fletëpalosje dhe broshura, në mënyrë që këshillat e mbrojtjes nga thumbimi i rriqrave, të mund të barten edhe tek qytetarët tjerë, në familjet e nxënësve dhe të personelit arsimor.

Kanë filluar ligjëratat në shkolla për vetëdijesim nga rreziku EHKK

Malishevë, 23 mars



Në mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillit të Drejtorëve, të drejtuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, gjatë raportimit të drejtorëve të drejtorive komunale, u bë e ditur, se sot kanë filluar ligjëratat, nëpër shkollat e Komunës e Malishevës, për vetëdijesimin e nxënësve, me qëllim të mbrojtjes nga thumbimi i rriqrave si masë parandaluese kundër infektimit me etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

Fillimisht në mbledhjen e sotme, kryetari Begaj, i ka uruar drejtorët e rinj, duke ju dëshiruar sukses në punë dhe ju ofroi mbështetje në detyrat e tyre. Më pas kryetari Begaj, tha se “pasi tashmë jemi në vllugun e fillimit të realizimit të projekteve, ku shumë prej tyre janë të rëndësishme”, kërkoi që të mos ketë lëshime, edhe pse normalisht gjatë realizimit të projekteve, lindin edhe probleme të natyrave të ndryshme.

Nga ana tjetër drejtorit për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, bëri të ditur se sot kanë filluar ligjëratat në pesë shkolla : Bellanicë, Kijevë, Pagarushë, Carrallukë dhe Llozicë , për të vazhduar më pas sipas orarit të paraparë në fshatrat tjerë “ligjëratat do të mbajnë personeli mjekësor i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Malishevë dhe këto ligjëratat janë në kuadër të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK)”, tha drejtori Berisha.

Po ashtu edhe drejtori për Bujqësi z.Hajrullah Mazreku ka bërë të ditur se sot ka filluar edhe fushata e repelimit të kafshëve shtëpiake.

Edhe drejtorët e tjerë raportuan për punët e kryera gjatë javës së kaluar, planifikimet dhe detyrimet në javët në vazhdim dhe për projektet që janë duke u realizuar në vazhdimësi.

Filloi fushata e repelimit të kafshëve shtëpiake

Malishevë, 23 mars



Në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), në territorin e Komunës së Malishevës, ka filluar fushata e repelimit të kafshëve, me qëllim që kafshët, të mos i sjellin rriqrat nga fusha në shtëpi dhe rrjedhimisht të zvogëlohet mundësia e thumbimit nga rriqrat, pasi rriqrat janë bartësit kryesor i etheve hemorragjike krime kongo, që e përcjellin virusin



tek njeriu.

Repelimi i kafshëve, organizohet nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Komunale për Bujqësi dhe shtabin komunal që merret me menaxhimin e situatës endemike nga EHKK.

Për këtë qëllim, fillimin e kësaj fushate, sot e kanë përcjellë nga afër edhe drejtori komunal për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku dhe ai për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, të cilët edhe kanë biseduar me pronarët e bagëtive, nëse janë të kënaqur me këtë repelimin e bagëtive të tyre.

Fushata e repelimit po ecën mirë në ditën e parë dhe nuk është regjistruar asnjë problem gjatë trajtimit të kafshëve.

Repelimin e kafshëve, është duke e bërë operatori i zgjedhur nga AVU, “Fauna”.

Kryetari Begaj, takoi banorët e Maxharrës dhe Astrazupit

Malishevë, 24 mars

Në kuadër të vizitave dhe takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, mbrëmë i kanë takuar banorët e fshatrave Maxharrë dhe Astrazup, me të cilët kanë biseduar për çështje të ndryshme, si dhe i kanë njoftuar ata me angazhimet e komunës, si në investime, ashtu edhe për prioritetet, si dhe për angazhimin e komunës për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike dhe mbrojtjen e ambientit.

“Qëllim i yni është t’ju dëgjojmë juve dhe ky është obligim i yni, që të takojmë qytetarët, të shkojmë ne te qytetari dhe jo qytetari të vrapoj pas neve”, ju ka thënë kryetari Begaj banorëve të Maxharrës dhe Astrazupit. Ndërsa drejtori Berisha, tha se “si qeveri komunale, nuk duam të menaxhojmë nga zyrat, por konform kërkesave të qytetarëve dhe atë nga bashkëbisedimi i drejtpërdrejtë me ju”.

Kryetari Begaj, pasi i njoftoi me angazhimet dhe aktivitetet e përgjithshme të komunës, i njoftoi ata se përveç investimeve, prioritet i qeverisjes së tij, është mbrojtja e ambientit, pasi ambienti është degraduar dhe ndotur në atë masë, sa ne sot rrezikohemi seriozisht nga sëmundjet që mund të vijnë nga kjo ndotje.

E drejtori Berisha, i ka njoftuar për masat e komunës, në luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), duke filluar me ligjëratat për vetëdijesim të qytetarëve për mbrojtje nga thumbimi i rriqrave, pastaj fushatat e ndryshme të dezinfektimit, repelimit të kafshëve, e deri te trajtimi i rasteve të thumbimit. “Pavarësisht se komuna, ka një buxhet prej 800 mijë eurove, më pak për investime, kryetari Begaj, e ka rritur fondin për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo, me qëllim të vetëm, mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të Komunës së Malishevës”, tha drejtori Berisha.

Kryetari Begaj, duke mos dhënë premtime të shumta, pasi sipas tij, “fillimisht dua të kryhet puna e pastaj të flasim”, tha se për Maxharre, do të vazhdohet me rregullimin e kanalizimit të fshatit si dhe rritjen e kapacitetit të ujësjellësit, ndërsa në Astrazup, kryetari tha se “këtë vit besojmë shumë se do të filloj ndërtimi i shkollës dhe jemi të angazhuar si një prej prioriteteve, në ndërtimin e ujësjellësit për Astrazup”.

E banorët e Maxharrës, kërkuan nga komuna, që t’ju ndihmoj në rregullimin e trafaje, pasi kanë probleme me energji elektrike, pastaj rregullimin e një pjese të kanalizimit, një rruge si dhe rregullimin e shtratit të lumit, kurse një brengë e fshatit, është edhe rreziku që kanë nga tensioni i lartë i rrymës, pasi kohë më parë një banorë, është lënduar rëndë nga telat e këtij rrjeti, që kalon shumë ulët në afërsi të shtëpive.

Ndërsa banorët e Astrazupit, kërkuan që të rregullohet shtrati i rrjedhës së kroit në fshat, asfaltimin e një rruge dhe kërkuan të ndihmohet një familje në ndërtimin e shtëpisë, pasi jeton në gjendje të rëndë dhe vetëm në një dhomë. Përveç këtyre kërkesave, ata kërkuan edhe ndërtimin e shkollës, një trotuar dhe riparimin kanalizimit në një pjesë të fshatit.

Begaj: Do ta rregullojmë rrugën Marali-Gajrak

Malishevë, 25 mars



Në kuadër të takimeve të drejtpërdrejta me banorët në fshatrat e Komunës së Malishevës, kryetari Begaj, i shoqëruar nga drejtori Hajdin Berisha, mbrëmë janë takuar me banorët e fshatit Marali, me të cilët kanë biseduar për çështje të ndryshme që ka nevojë fshati i tyre, si dhe angazhimet e komunës dhe obligimet, në raport me qytetarët.

“Vullneti im është që ti takoj të gjithë, por unë dua që ju të na jepni vërejtje, të jepni sugjerime, pasi kjo neve na ndihmon në punën tonë”, tha kryetari Begaj, ndërsa drejtori Berisha, tha se “ne nuk jemi këtu për të rrahur gjoks e as për tu lavdëruar, por jemi këtu që ti marrin kërkesat dhe nevojat e juaja, që përmes këtyre, ti bëjmë edhe planifikimet për prioritetet e komunës”.

Sikur edhe në takimet tjera, përveç njoftimit me punët e kryera dhe prioritetet e këtij viti, kryetari Begaj, i ka trajtuar dy tema me rëndësi, ajo për mbrojtje të ambientit dhe luftimi i EHKK. “Mbrojtja e ambientit, do të vazhdoj të jetë prioritet i imi, andaj kërkoj nga të gjithë ju, që ta ruajmë ambientin, ti largojmë ato deponi ilegale”, tha Begaj

Ndërsa duke folur për investimet kapitale, kryetari Begaj, tha se “këtë vit kemi planifikuar dhe besojmë shumë, që do ta rregullojmë rrugën që lidh fshatin Marali dhe Gajak, pavarësisht terrenit të vështirë, pasi këto dy vendbanime, edhe pse janë shumë afër, ju duhet të kaloni kilometra të tëra, për të shkuar nga Maralia në Gajak dhe anasjelltas”. Ndërsa, për çështjen e ujësjellësit, kryetari Begaj, tha se “Komuna, ka mundësi të investoj, por ne jemi në kërkim të burimit të ujit dhe ky është problemi kyç, për ndërtimin e ujësjellësit, por besoj se edhe burimin ujit do ta gjejmë, dhe ujësjellësi do të ndërtohet edhe për Marali dhe fshatra tjerë”.

Lidhur me situatën me ethet hemorragjike krime kongo, foli drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, i cili i njoftoi me aktivitetet, por edhe masat mbrojtëse, parandaluese, që duhet të bëjnë qytetarët, në mënyrë që të mos thumbohen nga rriqrat, mirëpo edhe nëse thumbohen, kërkoi që të bëjnë kujdes, dhe mos ti largojnë rriqrat vet, por të kërkojnë ndihmën e mjekut në QKMF.

Banorët e fshatit Marali, kërkuar që të intervenohet në riparimin e kanalizimit, pasi herë pas here kanë problem me rrjedhën e kanalizimit, për çka morën premtimin e Begajt, se do angazhohen në riparimin e këtij defekti.

Qytetarët kërkojnë rikthimin me regjionin e Prizrenit

Malishevë, 26 mars



Përveç reagimit të mëhershëm të Komunës së Malishevës dhe Kuvendit të Komunës, pas kalimit në regjionin e Gjakovës, pa e pyetur komunën dhe qytetarët, këta të fundit, mbrëmë gjatë takimeve të kryetarit me banorët, kanë kërkuar që të bëhet presion dhe të gjinden forma, për tu rikthyer me regjionin e Prizrenit, ashtu siç kemi qenë gjithmonë dhe ashtu siç jemi të lidhur në çdo formë me Prizrenin, jo vetëm shpirtërisht, por edhe me infrastrukturë, edhe me ekonomi dhe me çdo formë tjetër, ku si rrjedhojë edhe një numër i madh i familjarëve jetojnë dhe punojnë në Prizren.

“Ne kemi kërkuar sqarime nga ministria dhe organet përkatëse, por deri më tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Komuna nuk është pyetur dhe kjo është bërë nga niveli qendror pa vullnetin e Komunës së Malishevës dhe pa vullnetin e qytetarëve të Malishevës. Ne jemi duke shikuar të gjitha format dhe mundësitë ligjore për tu rikthyer me Prizren dhe të shfrytëzojmë çdo mundësi që kemi”, tha kryetari Begaj, para banorëve të Dragobilit, të cilët kërkuar sqarime rreth kësaj çështje dhe kërkuar kthimin me regjionin e Prizrenit. Begaj, kritikoi edhe ish deputetët nga Malisheva, në Kuvendin e Kosovës, të cilët në kohën kur është miratuar ai vendim për kalim me regjionin e Gjakovës, kanë heshtur dhe nuk e kanë kundërshtuar.

Përndryshe, mbrëmë kryetari Begaj, i shoqëruar nga drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, kanë takuar banorët Gurishtës dhe Dragobilit, me të cilët kanë biseduar për çështje të ndryshme, si për investime, pastaj mbrojtje të ambientit dhe për masat parandaluese kundër etheve hemorragjike krime kongo.

Në Gurishtë, kryetari Begaj, tha se përveç shkollës që është duke u ndërtuar, tha se beson shumë se do të bëhet një zgjidhje edhe për kanalizimin e fshatit, pasi është i vetmi fshat që nuk ka kanalizim. “Nuk dua të jap premtime, por dua që fillimisht të kryhet puna, e pastaj mund të flasim për to”, tha kryetari Begaj, i cili po ashtu, tha se me gjetjen e burimit të ujit, do të bëhet gjithçka që të ndërtohet edhe ujësjellësi.

Ndërsa në Dragobil, kryetari Begaj, tha se me buxhet të komunës, do të ndërtohet një rrugë për një lagje të re në këtë fshat, ndërsa bëri të ditur se ka kërkuar fonde edhe nga ministritë përkatëse, për ndërtimin e një nënkalimi afër shkollës, pas dy fshatrat që frekuentojnë në këtë shkollë, gjinden në anën tjetër të rrugës.

Në këto takime është biseduar edhe mbrojtje të ambientit, si dhe për masat parandaluese kundër etheve hemorragjike krime kongo, masa për të cilat, i ka njoftuar drejtori për shëndetësi Hajdin Berisha.

Kryetari Begaj, takoi përfaqësuesit e LMT-së në Malishevë

Malishevë, 26 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur në zyrën e tij, në një takim të rregullt, përfaqësuesit e njësisë së LMT-së zvicerane në Malishevë, kapitenët J.Oser dhe F.Loetcher, me të cilët kanë biseduar për bashkëpunimin e rregullt të komunës dhe LMT-së dhe çështja tjera me interes të përbashkët.

Në këtë takim, udhëheqësi i njësisë së LMT-së në Malishevë, kapiteni J.Oser, e prezantoi edhe pasardhësin e tij, kapitenin F.Loetcher, i cili pas tri javësh, do ta merr komandën e njësisë në Malishevë.

Kryetari Begaj, e falënderoi kapitenin Oser, për bashkëpunimin e deritanishëm dhe i uroi mirëseardhje udhëheqësit të ri dhe i ofroi bashkëpunim gjatë punës së tij.

Vazhdon projekti për përkujdesjen shëndetësore në mes Komunës dhe Caritas Kosova

Malishevë, 26 mars



Komuna e Malishevës dhe Caritas Kosova, sot kanë nënshkruar marrëveshjen për vazhdimin e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit të projektit për “Përkujdesjen shëndetësore shtëpiake-shtretërit shtëpiak”. Vazhdimi i këtij projekti, sot është nënshkruar nga Don Viktor Sopi, drejtor i përgjithshëm i Caritas Kosova dhe Ragip Begaj, kryetar i Komunës së Malishevës.

Sipas marrëveshjes, parashihet shpenzimet e transportit për pacientet në dializë, shpenzimet për përkujdesjen shtëpiake, për të gjitha familjet në nevojë, përmirësimi i kushteve për personat me regjim dialize, asistencë për disa arsimtar me probleme shëndetësore, përkujdesje për disa persona të sëmurë dhe të moshuar, që kanë nevojë për përkujdesje permanente, si dhe rritjen e standardit të jetesës, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore në familjet e tyre.

Në këtë projekt, do të jenë të punësuar 30 persona, ndërsa kohëzgjatja e marrëveshjes për bashkëpunim dhe bashkëfinancim në mes Komunës dhe Caritas Kosovës do të jetë deri me 31 dhjetor 2015.

Komuna do ta mbështes Shoqatën e të Verbërve në Malishevë

Malishevë, 26 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës (SHVK), z.Mexhid Foniqi, dhe përfaqësuesin e Shoqatës së të Verbërve të Malishevë z.Isak Krasniqi, me të cilët kanë biseduar për gjendjen e tyre në përgjithësi dhe përkrahjen që mund ta kenë nga ana e Komunës së Malishevës

Kryetari Begaj me këtë tha se, ”ne si komunë, do ti shfrytëzojmë të gjitha mundësitë tona, për ti ofruar mbështetje shoqatës në Malishevë dhe përkujdesja jonë nuk do të mungoj edhe këtë vit, për këtë kategori, të cilët duhet të ndihen pjesë e barabartë e shoqërisë”.

Nga ana tjetër z.Mexhid Foniqi para kryetarit Begaj, shpalosi qëllimin e vizitës së tij, ku ishte bashkëpunimi i Komunës së Malishevës me Shoqatën e të Verbërve në Malishevë me qëllim të ofrimit të shërbimeve specifike për personat e verbër të Komunës së Malishevës, si janë shkrimi,

leximi Brail, orientim në hapësirë, teknologjia informative dhe trajnime psiko-sociale për të verbër.

Kryetari Begaj, vazhdon të mbaj derën hapur për qytetarë

Malishevë, 27 mars

Si çdo të premte, edhe sot, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, e ka mbajtur derën hapur për qytetarë, ka pritur e përcjellë, dhjetëra qytetarë të Komunës së Malishevës, të cilët kishin mësy zyrën kryetarit, për ti paraqitur problemet, hallet dhe nevojat e tyre apo të komunitetit ku jetojnë.

Problemet dhe kërkesat e qytetarëve, ishin të ndryshme, duke filluar nga ato sociale, ekonomike, e deri tek problemet e komunitetit, siç është rregullimi i infrastrukturës në lagjet e tyre, dhe për të gjitha këto, qytetarët kanë marr përgjigje, apo këshilla nga kryetari për formën e zgjidhjes së nevojave të tyre.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, çdo pasdite të së premtes, e ka të rezervuar për pritjen e qytetarëve në zyrën e tij.

Begaj dhe Mustafa: Regjionalizimi sipas vullnetit të qytetarëve

Malishevë, 28 mars



Kryeministri i vendit, z.Isa Mustafa, ka vizituar sot Komunën e Malishevës, ku është pritur nga Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ku kanë biseduar për çështje të ndryshme, përfshi edhe çështjen e kalimit në regjionin e Gjakovës, ku kryeministri Mustafa, tha se “kjo çështje nuk mund të zgjidhet jashtë vullnetit të qytetarëve dhe për këtë çështje nuk ka vendim të qeverisë”.

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, pasi e falënderoi Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Isa Mustafa, për vizitën në Komunën e Malishevës, para tij, paraqiti tri nga brengat e shumta të Malishevës. “Ethet hemorragjike, transiti për qytetin e Malishevës dhe kalimi në regjionin e Gjakovës, janë tri hallet më të mëdha të Malishevës”, tha kryetari Begaj.



“Ne jemi një komunë e lënë pas dorë dhe shpresoj që tash e tutje, të kemi kujdesin e qeverisë së vendit”, tha Begaj.

Kryeministri i vendit, z.Mustafa, pasi sqaroi se është i njoftuar me gjendjen dhe nevojat e Malishevës, premtoi se angazhim i tij personal, nuk do të mungoj në zgjidhjen e problemeve. “Çështja e etheve hemorragjike, është një problem serioz shëndetësor, të cilin jam i interesuar që mos mbetet në duart e komunës, por institucionet përkatëse, përgjegjëse, të merren edhe më seriozisht”, tha kryeministri Mustafa. Ndërsa për investime në infrastrukturë, kryeministri, tha se “do ta ketë parasysh Malishevën, dhe Malisheva nuk do të mbetet e anashkaluar, por e barabartë me komunat tjera, duke përfshi infrastrukturën në përgjithësi, si në rrugë, shkolla, e po ashtu edhe në kulturë. “Me rishikim të buxhetit, do të kemi mundësi që të zgjidhim shumë nga problemet dhe këtë do ta bëjmë bashkërisht, por, për mua me rëndësi është përmirësimi i jetës së qytetarëve dhe këtë planifikojmë të bëjmë përmes investimeve në fushat që ndikojnë në përmirësimin e jetës, në zhvillimin e ekonomik, më saktësisht në fushën e bujqësisë, fushë e cila është prioritet”.

Sa i përket çështjes së kalimit në regjionin e Gjakovës, kryetari i Malishevës, tha se “kemi reagime të qytetarëve dhe unë kërkoj që ju personalisht, si i pari i qeverisë, të merreni me këtë çështje, sepse ne nuk jemi pyetur dhe nuk dëshiroj që nesër qytetarët, pakënaqësinë e tyre ta shprehin përmes formave të cilat nuk do ti dëshironte askush”.

Për këtë çështje, kryeministri Mustafa, tha: Në qeveri nuk ka asnjë vendim për kalimin e Malishevës në regjionin e Gjakovës, mirëpo disa ministri, disa sektore i kanë kaluar në kompetencë të regjionit të Gjakovës. Për këtë, unë ju them se kjo nuk mund të bëhet jashtë vullnetit të qytetarëve dhe do të angazhohem personalisht për zgjidhjen e këtij shqetësimi të qytetarëve të Komunës së Malishevës.

KK i Malishevës nuk pranoi ndryshimin e statutit

Malishevë, 30 janar



Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi z.Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e tretë të radhës për këtë vit, ku në mesin e shumë pikave, ka shqyrtuar edhe propozimin e MAPL-ës, për ndryshimet në statutin e Komunës së Malishevës, kërkesë e cila nuk u pranua nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës, pasi në mesin e propozimeve për ndryshime ishte edhe pika 2 e statutit, ku përmendët lufta e UÇK-së dhe një pikë tjetër, ku përmendën festat, e që me



statutin e Komunës së Malishevës, 28 Nëntor, është festë.

“Kuvendi i Komunës së Malishevës, qëndron prapa punës së bërë nga ana e komisionit që ka hartuar statutin e komunës”, tha kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, pas debatit të gjerë rreth kësaj dhe pas konsultimeve mes udhëheqësve të subjekteve të përfaqësuara në KK të Malishevës.

Përndryshe, në këtë mbledhje, anëtarët e KK të Malishevës, kanë miratuar destinimin e të hyrave vetanake nga viti 2013 dhe 2014 në vitin 2015, planin e punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2015, kanë miratuar në lexim të parë i Draft Rregullores, për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, pastaj miratuan në lexim të parë Draft Rregulloren, për ndarjen e bursave për studentë, si dhe iniciuan ndryshimet në Rregulloren për menaxhimin e varrezave publike.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, KK i Malishevës, ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e punës për vitin 2014 të Komisionit Komunal të Aksionareve, si dhe planin e punës për vitin 2015, si dhe kanë marrë vendim për pagesën regjistrimin e fëmijëve në çerdhe, e shuma e cila u miratua, është 30 euro për një fëmijë.

Ndërsa rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, me kërkesën e anëtarëve të KK-së, është shtyrë për mbledhjen e ardhshme.

Në mbledhjen e sotme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, ka dhënë betimin Valon Hoti nga subjekti i VV-së, e që zëvendëson ish anëtarin e derisotshëm Muhamet Bytyçin.

Përkujtohet “Masakra e Burimit”

Malishevë, 31 mars



Përmes homazheve, sot është përkujtuar “Masakra e Burimit”, njëherit masakra më e madhe në Komunën e Malishevës, që ka ndodhur gjatë luftës së fundit, ku tek “Vrella e Mëhillit” në Burim (ish Joviq), janë vrarë e masakruar 42 qytetar të pafajshëm, kryesisht nga fshatrat Dragobil dhe Astrazup dhe të tjerë, të strehuar në



këtë pjesë, gjatë gjenocidit serb në Kosovë. Kjo masakër ka ndodhur më 31 mars 1999.

Në varrezat e të vrarëve të “Masakrës së Burimit”, në Dragobil, sot janë bërë homazhe nga ana e familjarëve dhe zyrtarëve komunal, të cilët i kanë përkujtuar të rënët në këtë masakër.

Një delegacion nga Komuna e Malishevës, i prirë nga nënkryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku, drejtorë të drejtorive komunale, anëtar të Asamblesë Komunale dhe zyrtarë të tjerë komunal, si dhe përfaqësues të partive politike, kanë bërë homazhe në varrezat e martirëve në Dragobil dhe në vendin e vrasjes në Burim, përkatësisht te “Vrella e Mëhillit”.

“Masakra e Burimit”, është masakra më e madhe në Malishevë, ku paramilitaret serb, i kishin zënë një pjesë të popullatës, dhe i kishin ndarë meshkujt, të cilët më pas i kanë vrarë e masakruar, saktësisht 38 persona, ndërsa jo larg këtij vendi, i kishin djegur së paku katër të tjerë. Të vrarët janë nga fshatrat Dragobil dhe Astrazup dhe disa të tjerë nga fshatrat e Suharekës, të cilët ishin strehuar në këto dy fshatra.

Edhe pse kjo është masakra me më së shumti të vrarë në territorin e Komunës së Malishevës, deri më tani, nuk është ngritur asnjë padi dhe rrjedhimisht nuk është dënuar askush, për këtë masakër.